



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 7 pika 7.3 dhe 7.5 të Ligjit nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë .

Duke pasur parasysh mundësin e ndryshimit të rrethanave të cilat mund të ndikojnë në shfrytëzimin e të drejtës në pensionin e aftësisë së kufizuar .

Me qëllim të shfrytëzimit sa më racional dhe efikas të mjeteve financiare të dedikuara për pensionet e aftësisë së kufizuar, Ministri i Ministrisë së punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV 03/2005
PËR PROCEDURAT E MONITORIMIT DHE RISHQYRTIMIT TË SE DREJTËS
PËR PENSIONET E AFTESISË SE KUFIZUAR**

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

1.1 Përmes këtij Udhëzimi Administrativ do të rregullohen dhe përcaktohen procedurat e monitorimit dhe rishqyrtimit për pensionet e aftësisë së kufizuar ,për ta konfirmuar aftësinë e vazhduar të kufizuar të shfrytëzuesve të këtyre pensioneve .

Neni 2

Autoriteti i inspektimit

2.1 Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale përkatësisht Divizioni i skemave pensionale të Departamentit të Administratës pensionale ,me autorizim të Drejtorit të DAPK dhe të Sekretarit të Përhershëm të MPMS-së caktojnë grupe punuese të inspektimit apo nëpunës individual për monitorimin dhe rishqyrtimin e pensioneve më aftësi të kufizuara .

- 2.2** Grupet punues apo nëpunësit civil të inspektimit ,me rastin e monitorimit dhe rishqyrtimit të pensioneve më aftësi të kufizuar, duhet të kenë veprime të kujdesshme si dhe sjelljet e tyre duhet të jenë në përputhje me kodin e mirësjelljes së nëpunësve civil të Shërbimet Civil të Kosovës.
- 2.3** Shfrytëzuesit e pensioneve të aftësisë se kufizuar nuk duhet paralajmëruar për vizitat dhe inspektimet ,ne qoftese ato zhvillohen në kohën e përshtatshme gjatë ditës.
- 2.4** Grupet punuese apo nëpunësit administrativ të inspektimit mund të bëjnë inspektime te rastësishme apo sistematike ,të personave të cilët janë shfrytëzues të pensionit të aftësisë ,me qëllimi të verifikimit të fakteve te prezantuara në kërkesë për pensionin e aftësisë se kufizuar .
- 2.5** Grupet punuese apo nëpunësit e autorizuar për inspektim,me rastin e inspektimit të shfrytëzuesi i pensionit të aftësisë se kufizuar,duhet të kenë autorizimin ne forme të shkruar si dhe shenjen identifikuese të MPMS –së për të bërë monitorimin dhe verifikimin e fakteve të cilat kanë qenë vendimtare në aprovimin e kërkesës për pensionin e aftësisë se kufizuar.
- 2.6** Për rastet e inspektimit , grupet punuese apo nëpunësit e autorizuar të inspektimit ,duhet të përpilojnë procesverbal me shkrim dhe të raportojnë më shkrim tek zyrtaret kompetent të MPMS-së përkatësisht të Divizioni i skemave Pensionale në DAPK

Neni 3 Rivlerësimet mjekësore

- 3.1** Të gjithë shfrytëzuesit e pensioneve të aftësisë se kufizuar, të cilët e kanë fituar te drejtën në këtë pension në afat të caktuar ,mund të monitorohen dhe të inspektohen nga komisioni i inspektues apo nëpunësi i autorizuar për inspektim i MPMS-së.
- 3.2** Përfituesit e pensioneve të aftësisë se kufizuar të cilët kanë fituar të drejtën në këtë pension ne afat të caktuar kohorë me propozim të nëpunësve inspektues para skadimit të afatit për shfrytëzimin e pensionit mund të ftohen në rivlerësim mjekësor para komisionit mjekësor të MPMS-së.
- 3.3** Rivlerësimet mjekësore zhvillohen për ta konfirmuar aftësinë e vazhdueshme të kufizuar të përfituesit të pensionit të aftësisë se kufizuar ,si dhe për të shikuar mundësinë e punësimit apo të vetëpunësimit në përputhje me aftësitë e punës të shfrytëzuesit të pensionit të aftësisë se kufizuar.

Neni 4

Dokumentacioni i nevojshëm për rivlerësimin mjekësor.

4.1 Shfrytëzuesit e pensionit me aftësi të kufizuara ,me rastin e paraqitjes para komisioneve mjekësore për rishqyrtimin e kërkesës për këtë pension, janë të detyruar që për rivlerësimet mjekësore ,të sjellin dëshmi të reja mjekësore nga ekspert mjekësor të fushës përkatëse ,për të vërtetuara aftësinë e kufizuar.

4.2 Dëshmia mjekësore duhet të përmbaj saktësisht të dhëna përkitazi me:

- Konfirmimin apo ndryshimin e gjendjes shëndetësore –ndryshimet fizike ,mendore apo sensitive të aftësisë se kufizuar të shfrytëzuesit të pensionit se aftësisë se kufizuar
- Shkaqet e konfirmimit të gjendjes se mëparshme shëndetësore apo shkaqet dhe pasojat e ndryshimit të gjendjes shëndetësore tek shfrytëzuesi i pensionit me aftësi të kufizuar si dhe
- Vlerësimin e aftësisë për punë me prognozën mjekësore për aftësinë e përhershme të kufizuar

Neni 5

Procedurat për rishqyrtimin dhe rivlerësimin mjekësor

5.1 Autoriteti përkatës (DAPK), përmes ftesës me shkrim e njofton shfrytëzuesin e pensionit të aftësisë se kufizuar ,për rishqyrtimin e kërkesës dhe rivlerësimin mjekësor.

5.2 Në ftesë duhet shënuar data ,koha dhe vendi i paraqitjes se shfrytëzuesit të pensionit për rishqyrtim dhe rivlerësim mjekësor.

5.3 Rishqyrtimi dhe rivlerësimi kryhet nga Komisioni mjekësor i autoritetit përkatës ,i cili është i ngarkuar për vlerësime mjekësore në pajtim me Ligjin për pensionet e aftësisë se kufizuar

5.4 Ndaj vendimit të Rishqyrtimit dhe rivlerësimit mjekësor të autoritetit përkatës ,pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroi ankesë ,Këshillit të ankesave të MPMS-së si organ i shkalles se dytë i administratës .

5.5 Vendosja sipas ankesës nga këshilli i ankesave të MPMS-së bëhet në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për pensionet e aftësisë se kufizuar .

Neni 6

Hyrja në fuqi

6.1 Ky udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

Prishtinë ,mars 2005

Ministri i MPMS-së
